



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria e Arsimit
04/Nr.122

Me dt. 28/04/2021

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 62 paragrafi 62.3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 7 të Rregullores Për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës me numër të protokollit 01 Nr.110/01-3560 të dt.04/02/2020, Drejtori i Drejtorisë për Arsim shpall:

KONKURS

PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË GJAKOVËS

- I. Komuna e Gjakovës ndan 61 (gjashtëdhjetë e një) bursa për studentë si dhe 5 (pesë) bursa për komunitetet pakicë të cilët studiojnë në Universitetet Publike të Kosovës, për vitin akademik 2020/2021, në këto fusha studimi:

- 1. Fakulteti i Arteve**

- Drejtimi muzikë 1 bursë
- Drejtimi art 1 bursë
- Drejtimi aktrim 1 bursë

- 2. Fakulteti i Shkencave Sportive - 2 bursa**

- 3. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës**

- Drejtimi konstruktiv 2 bursa
- Drejtimi hidroteknike 2 bursa
- Drejtimi arkitekturë 2 bursa
- Drejtimi gjeodezi 2 bursa

- 4. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike 3 bursa**

- 5. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike 4 bursa**

- 6. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë**

- Drejtimi Bujqësi - 1 bursë
- Drejtimi Veterinari - 1 bursë

- 7. Fakulteti i Mjekësisë**

- Drejtimi Mjekësi e Përgjithshme - 8 bursa
- Drejtimi Farmaci - 2 bursa
- Drejtimi Stomatologji - 2 bursa

8. Fakulteti i Shkencave Matematiko – Natyrore

- Drejtimi Matematikë	4 bursa
- Drejtimi Shkenca Kompjuterike	2 bursë
- Drejtimi Fizikë	3 bursa
- Drejtimi Kimi	2 bursë
- Drejtimi Gjeografi	2 bursë
- Drejtimi Biologji	2 bursë

9. Fakulteti Filologjik 2 bursa

10. Fakulteti Filozofik 2 bursa

11. Fakulteti Ekonomik 2 bursa

12. Fakulteti Juridik 2 bursa

13. Fakulteti i Edukimit 2 bursa

14. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike 2 bursa

15. Komunitetet pakicë - 5 bursa

II. Vetëm studentët/et që janë banorë të komunës së Gjakovës, pa kurrfarë dallimesh etnike, gjinore, fetare dhe politike, që janë të regjistruar në fakultete të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar studentët në studime pasuniversitare – master dhe doktoratë, kanë të drejtë të konkurrojnë për ndarjen e bursave të studimeve.

III. Kriteret për ndarjen e bursave janë:

- a. Nota mesatare prej 9 – 10 në fakultete ose suksesi i shkëlqyeshëm (20) pikë
- b. Nota mesatare prej 8 – 9 në fakultete ose suksesi shumë i mirë (15) pikë
- c. Nota mesatare prej 7 – 8 në fakultete ose suksesi i mirë (10) pikë
- d. Rastet me gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale (20) pikë
- e. Fëmijët pa prind..... (20) pikë
- ë. Personat me aftësi të kufizuara..... (15) pikë

Në kushtet e barabarta të vlerësimit të kriterëve, përparësi kanë fëmijët e dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteranëve të luftës dhe familjeve që kanë dy apo më tepër studentë.

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

1. Aplikacioni sipas formës së Komunës;
2. Kopja e ID-ës së studentit;
3. Kopja e letërnjoftimit;
4. Ekstrakti i lindjes;
5. Deklarata e bashkësisë familjare;
6. Vërtetimi se studenti ka regjistruar vitin akademik 2020/2021, sipas vitit të aplikimit për bursë (origjinale);
7. Certifikata e notave (origjinale);
8. Vërtetimi që studenti nuk është përfutës i bursës nga Universiteti apo MASHTI;

9. Certifikata / Diplomave për përfundimin e shkollës së mesme të lartë (kopje). Çdo aplikacion në mungesë të këtij dokumenti konsiderohet se nuk është banor i Komunës së Gjakovës për më tepër se 10 vite;
10. Vërtetimit nga Administrata Tatimore që nuk jeni në marrëdhënie pune;
11. **Për anëtarin e ngushtë të familjes së dëshmorëve:**
Vendimi / Vërtetimi se është anëtar i ngushtë i familjes së dëshmorëve;
12. **Për anëtarin e ngushtë të familjes në asistencë sociale:**
Vendimi / Vërtetimi që dëshmon se aktualisht është shfrytëzues i ndihmës sociale (origjinale);
13. **Për studentë e regjistruar për herë të parë në vitin akademik aplikues:**
Kopjet e vërtetuara të dëftësave dhe të diplomës për përfundimin e shkollës së mesme;
14. **Për studentë me nevoja të veçanta:**
Vendimi / Vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

Vërejtje : Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

Komisioni Vlerësues:

Përzgjedhja e përfituesve bëhet nga komisioni vlerësues i propozuar nga ana e njësisë kërkuese duke u aprovuar me vendim nga ana e Kryetarit të Komunës. Komisioni vlerësues nuk është organ i përhershëm, por emërohet pas publikimit të thirrjes për aplikim dhe shpërbëhet menjëherë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit. Komisionit vlerësues është përgjegjës për menaxhimin e vlerësimit, përgatitjen e listës së shkurtë dhe listës së përfituesve përfundimtar. Në rast kur në një profil të caktuar nuk ka aplikues / përfitues të bursës, atëherë komisioni i vlerësimit ka të drejtën e rialokimit të bursave tek profilet me prioritet. Në përfundim të procedurës së vlerësimit, Komisioni pas shqyrtimit të kërkesave përpilon një raport / procesverbal të punës dhe të njëjtin e dorëzon tek Drejtori i njësisë përkatëse, i/e cili/a mbi bazën e rekomandimeve nga raporti, ia përcjell dokumentacionin Kryetarit për vendimmarrje.

Kandidatëve të cilëve iu ndahet bursa për kushtet e shfrytëzimit do të nënshkruajnë kontratë të veçantë, ku do të precizohen kushtet, obligimet dhe detyrat e dyanshme.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes në tabelën e shpalljeve në Drejtorinë e Arsimit, në mjetet e informimit publik dhe në web-faqen e Komunës së Gjakovës:
<https://kk.rks-gov.net/gjakove/>.

Konkursi mbetet i hapur prej dt.28/04/2021 e deri më dt.12/05/2021.

Aplikacioni i kërkesës merret në Drejtorinë e Arsimit në Gjakovë dhe i plotësuar dorëzohet në zyrën për pranim dhe arkiv në komunën e Gjakovës çdo ditë pune prej orës 10:00 deri 15:00.

Me respekt!

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit
Gjevalin Nikollbibaj





KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

DREJTORIA E ARSIMIT NË GJAKOVË

Formular i aplikimit për bursë komunale

Në bazë të konkursit publik të shpallur më datë 28.04.2021 aplikoj për bursë komunale .

1. Të dhënat personale

Emri _____ Emri i babës _____ Mbiemri _____
Data e lindjes _____ Numri personal _____ Vendlindja _____
Komuna _____ Tel fiks _____ Mobil _____
E mail _____

2. Adresa ku jeton

Rruga _____ Nr. _____ Fshati _____ Komuna _____

3. Te dhënat e studimeve

Indeksi /kartela nr. _____
Fakulteti _____ Drejtimi _____ Viti akademik _____
Nota mesatare _____ Universiteti _____ Vendi _____

1.	Kopja e ID studentit	
2.	Vërtetimi i regjistrimit të vitit akademik 2020/2021 (origjinale)	
3.	Certifikata e notave (origjinale)	
4.	Vërtetimi që studenti nuk është përfitues i Bursës nga Universiteti apo MASHTI	
5.	Ekstrakti i lindjes (ky dokument merret në Sektorin e Gjendjes civile)	
6.	Deklarata e Bashkësisë Familjare (ky dokument merret në Sektorin e Gjendjes civile)	
7.	Certifikata për përfundimin e shkollës së mesme (kopje). Çdo aplikacion në mungesë të këtij dokumenti do të konsiderohet se nuk është banor i Komunës së Gjakovës më tepër se 10 vite.	
8.	Kopja e letërnjoftimit	
9.	Vërtetimi nga Administrata Tatimore që nuk jeni në marrëdhënie pune	
10.	Vendimi/ Vërtetimi se jeni anëtar i ngushtë i familjes së dëshmorëve, martirëve dhe invalidëve të luftës	
11.	Vendimi/ Vërtetimi për anëtarin e ngushtë të familjes që jeni shfrytëzues i ndihmës sociale (origjinale)	
12.	Vendimi/ Vërtetimi për studentët me nevoja të veçanta nga MPMS	
13.	Për studentët e vitit të parë akademik 2020/2021 , kopjet e vërtetuara të dëftësave dhe diplomës së shkollës së mesme.	

Me përgjegjësi të plotë pohoj se të dhënat të cilat i kam dhënë janë të vërteta dhe të sakta.

Nënshkrimi _____

Data : _____